



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit  
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

## **“SHËRBIME KUJDESI PËR TË MOSHUAR”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar niveli III të KEK<sup>2</sup>**

**O1-III-2020**

**Tiranë më, Gusht 2020**

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

<b>Emërtimi i kualifikimit</b>	<b>“Shërbime kujdesi për të moshuar”</b>		<b>Kodi</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>900-1100 orë</b>	<b>Niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK</b>	<b>O1-III-20</b>
<b>Qëllimi:</b>	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” niveli III-të, <b>në KSHK</b> , referuar niveli III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për shërbime kujdesi për të moshuar, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e kujdesit për të moshuar.		
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” të nivelit të tretë <b>në KSHK</b> , referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> <li>– kanë përfunduar kualifikimin profesional “Shërbime sociale dhe shëndetësore”, niveli II <b>në KSHK, referuar niveli II të KEK;</b></li> <li>– janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul>		
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar”, niveli III-të <b>në KSHK</b> , referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë profesionale. <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në institucione që ofrojnë shërbime sociale dhe shëndetësore dhe kujdesi për të moshuar në qendra rezidenciale ose ditore për të moshuar, në shërbimet komunitare të përkujdesjes, në spitale, për t’u vetëpunësuar si kujdestar për të moshuar, mbas një përvoje pune, për të krijuar një biznes të vogël në fushën e shërbimeve sociale dhe shëndetësore për të moshuar.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV <b>në KSHK, referuar niveli IV të KEK</b>, (technik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm dhe universitare.</p>		
<b>Data e validimit</b>			
<b>Data e miratimit</b>			
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>O-III-01-12</b>		

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI

Individi duhet të dijë:

### Menaxhim dhe sipërmarrje

- Të shpjegojë rolin e sipërmarrjes sociale dhe ekonomike në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të vleftësojë mendime mbi çështje etike që lidhen me veprimtari të ndryshme ekonomike;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare..);
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të përshkruajë legjislacionin e punës dhe zbatimin përkatës;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve të nevojshme;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e përshtatjes së veprimtarisë me kërkesat e tregut global;
- Të argumentojë rëndësinë e planifikimit të veprimtarisë;
- Të dallojë teknikat e planifikimit të veprimtarisë;
- Të interpretojë rregullat e sigurisë në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit ergonomik të vendit të punës;
- Të përshkruajë strukturat organizative në një njësi ekonomike;
- Të argumentojë rëndësinë e vendimmarrjes sipas dinamikave të veprimtarisë;
- Të përshkruajë rëndësinë e monitorimit;
- Të dallojë llojet e raportimit dhe formatet përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK në shërbim të veprimtarisë së njësisë ekonomike;
- Të përshkruajë elementët e planit të biznesit;

### Të përgjithshme

- Të përshkruajë fazat e evolucionit sociologjik të familjes;
- Të përshkruajë legjislacionin e përgjithshëm dhe institucional në gerontologji;
- Të përshkruajë qëllimin dhe aspektet e përkujdesjes gerontologjike;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrëdhënieve familjare, duke përfshirë marrëdhëniet dhe konfliktet midis brezave dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre (çështje personale dhe të partneritetit);
- Të përshkruajë ndryshimet psiko-sociale, paaftësinë, plakjen,....në jetën e një individi;
- Të shpjegojë nevojën dhe rolin e socializimit dhe përfshirjes në jetën shoqërore të një individi dhe dimensionet e ndryshme të qasjes;
- Të listojë disa situata të sjelljes midis një individi me aftësi ndryshe dhe familjes;
- Të përshkruajë institucionet e shërbimit të kujdesit për të moshuar dhe shërbimet përkatëse të tyre;

- Të përshkruajë shërbimet kryesore sociale dhe mjeko-sociale të një institucioni të kujdesit për të moshuar;

### **Komunikimi**

- Të përshkruajë kuptimin dhe rëndësinë e komunikimit;
- Të listojë format e komunikimit dhe përdorimet e tyre;
- Të shpjegojë mënyrën se si komunikimi ndikon në punën tuaj;
- Të shpjegojë rëndësinë e shmangies së paragjykimit dhe supozimeve gjatë komunikimit;
- Të shpjegojë mundësinë e kontrollit të nivelit të shëndeti nëpërmjet komunikimit;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të ndryshimeve kulturore dhe mënyrën sesi ato mund të ndikojnë në komunikim;
- Të shpjegojë mundësinë e përdorimit të teknikave të stimulimit i aftësive mendore dhe fizike;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e raportimit dhe dyshimeve për keqtrajtim;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në parandalimin e problemeve mendore si p.sh. depresioni etj.;
- Të përshkruajë teknikat dhe modelet e komunikimit sipas rrethanave të ndryshme;
- Të shpjegojë mënyrën e prezantimit të shërbimit të klienti i moshuar;
- Të tregojë mënyrën e veprimit në rast pamundësie të ofrimit të një shërbimi të kërkuar;
- Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të situatës dhe nevojave të individit të asistuar;
- Të përshkruajë metodën e duhur të komunikimit me individin e asistuar për të kuptuar nevojat e tij;
- Të përshkruajë metodat e intervistimit, dëgjimin dhe vëzhgimin duke pasur parasysh moshën e dhe gjendjen fizike të individit të asistuar;
- Të përshkruajë mënyrën dhe nevojën dokumentimit dhe raportimit të shkruar dhe gojor sipas rastit të dhënë;
- Të përshkruajë mënyrën e formulimit të propozimeve dhe argumentimin e tyre;
- Të identifikojë modelet e komunikimit në marrëdhëniet familjare, të gjeneratave të ndryshme dhe marrëdhëniet ndërkulturore;
- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të komunikimit ndër personal dhe ndërinstitucional;
- Të përshkruajë mënyrën dhe domosdoshmërinë e komunikimit me institucionet të tjera si, policia, shërbimi shëndetësor, këshilltarët, psikologu apo njerëz të tjerë;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhës dhe vendosjes së formave të reja të komunikimit p.sh. Përmes platformave dixhitale, duke siguruar që njerëzit mund të vazhdojnë të kenë akses të ri dhe mbështetje nëse rrethanat e tyre ndryshojnë;
- Të shpjegojë nevojën e mbështetjes së anëtarëve të tjerë të familjes në periudhën para ose pas vdekjes së një anëtari të saj;

### **Organizimi i punës**

- Të përshkruajë metoda të analizës së informacionit të mbledhur dhe vendosjes së prioriteteve;
- Të përshkruajë format e dokumentimit dhe arkivimit të informacionit të mbledhur;
- Të përshkruajë metodat e diagnostikimit të situatës, për të vlerësuar potencialin e individit, si dhe disavantazhet e tij, të metat dhe paaftësitë;

- Të listojë etapat e hartimit të një plani të përkujdesjes shëndetësore ndaj individit sipas nevojave dhe aftësive të tij për ta realizuar;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të punës sipas përparësive dhe emergjencave;
- Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit dhe komunikimit me stafin tjetër: mjekësor, infermierinë, paramedikale, administrative, etj.;
- Të shpjegojë rëndësinë e negocimit dhe ndarjes së detyrave të punës;
- Të listojë masat parandaluese që merren në raste pandemie në parandalimin dhe në mospërhapjen e infeksioneve;
- Të listojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore për individët që ofrojnë kujdes shëndetësor;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të shërbimeve në banesë në distancë, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve;
- Të identifikojë nevojat për mbështetje të familjeve dhe të tjerëve të prekur drejtpërdrejtë nga vuajtja ose humbja e jetës për shkaqe të ndryshme;
- Të përshkruajë mënyrën e vendosjes së përparësive dhe prioriteteve në një situatë të dhënë duke pasur parasysh aftësitë e njerëzve, mjedisin, burimet, kufizimet, ..etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të boshllëqeve të një individi për të përcaktuar shkaqet e reagimeve dhe të përgjigjeve të tij;
- Të përshkruajë nevojën e rishikimit të planveprimi individual në përputhje me rrethanat e reja për të përgatitur një ndërhyrje të mëvonshme

#### **Shërbime të punonjësit të kujdesit për të moshuarit**

- Të shpjegojë rolin e punonjësit të shërbimit të kujdesit për të moshuarit në institucionet përkatëse;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit social;
- Të përshkruajë rolin e punonjësit të shërbimit të kujdesit për të moshuarit në edukimin e pacientëve dhe familjeve të tyre;
- Të listojë përdorimet e mediave sociale në shërbimet e kujdesit për të moshuarit;
- Të shpjegojë aplikacionet dhe përdorimet e teknologjisë dixhitale të shëndetit, sipas nevojave të përdoruesit për shërbimet e kujdesit për të moshuarit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përditësimit me udhëzimet për të ofruar zgjidhje të përshtatshme për pacientët/klientët e tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë e rolit ndërmjetësimit dhe ndihmës së pacientëve për përdorim optimal të programeve të kujdesit shëndetësor;

#### **Të drejtat, detyrimet dhe etika profesionale**

- Të listojë disa të drejta dhe detyrime të një individi në nevojë në një situatë të dhënë;
- Të listojë të drejtat dhe detyrat si punonjës i shërbimit social për kujdesin që ofron;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të rregullave në lidhje me etikën, konfidencialitetin dhe diskrecionin profesional, etj. ;
- Të listojë parimet të humanizmit dhe rëndësia e zbatimit të tyre në punën e përditshme;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e ruajtjes së respektit dhe dinjitetit të individit;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e zbatimit të parimi i autonomisë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të privatësisë gjatë përkujdesjes për individët në nevojë;

- Të shpjegojë domosdoshmërinë e informimit të individit në nevojë mbi procedurat e kryera;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit dhe zbatimit të kufijve përreth konfidencialitetit;
- Të përshkruajë rregullat dhe politikat rreth konfidencialitetit në procedurat që kryen;
- Të përshkruajë rëndësinë e promovimit të politikave gjithëpërfshirëse etike në menaxhimin e situatave të paparashikuara;
- Të përshkruajë nevojën e informimit të anëtarëve të familjes për të drejtat dhe detyrat e tyre;
- Të përshkruajë disa masa informimi mbi mbrojtjen ligjore për individët në nevojë;
- Të përshkruajë direktivat kryesore të politikës për mbrojtjen e personave të moshuar;
- Të përshkruajë direktivat dhe politikat në lidhje me strukturat dhe organizimin e shërbimeve sociale që ofrohen;

### **Puna në grup**

- Të përshkruajë teknikat e organizimit dhe lehtësimit të grupit;
- Të përshkruajë teknikat e mobilizimit dhe veprimit në grup;
- Të përshkruajë teknikat e vlerësimit të një veprimi kolektiv;
- Të përshkruajë rëndësinë e njohjes së diversitetit të individëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimi të klimës së respektit dhe mirëbesimit reciprok;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve të ngrohta sociale;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbështetjes dhe nxitjen e pjesëmarrjes aktive të grupit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes së teknikës së duhur të bashkëpunimit në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion;
- Të listojë disa argumente të nevojës së punës në grup;
- Të përshkruajë përdorimin e teknikave të menaxhimit të konflikteve dhe situatave të vështira;
- Të listojë parimet e ndërhyrjes në menaxhimin e konflikteve;

### **Përzgjedhjes së informacionit**

- Të përshkruajë mënyrën e përzgjedhjes së informacionit të nevojshëm për një shërbim cilësor ndaj të moshuarve;
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe të ruajtjes së informacionit;
- Të përshkruajë nevojën dhe metodat e aktualizimit të njohurive;
- Të shpjegojë nevojën e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Të tregojë mënyrën e formatimit/përmbledhjes dhe ristrukturimit të informacionit të mbledhur;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit dhe plotësimit të saktë të formularëve të evidentimit gjatë përkujdesjes geriartrike;
- Të përshkruajë saktë llojin e informacionit sipas nevojave specifike të individëve në nevojë;
- Të shpjegojë mënyrën e marrjes së vendimeve në një situatë të dhënë;
- Të përshkruajë mënyrat e nxitjes së shprehjes/komunikimit duke përdorur teknikat e komunikimit për të ndihmuar personin në nevojë;

### **AKTIVITETET KRYESORE TË JETËS SË PËRDITSHME**

### ***Organizimi i vakteve***

- Të listojë veprimet kryesore të kryera për të bërë blerjet ushqimore të nevojshme;
- Të përshkruajë mënyrën dhe bazat e menaxhimit të buxhetit të përditshme;
- Të shpjegojë nevojën e këshillimit për blerjet e përditshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të traditave dhe kulturës në të ushqyer të individëve.
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të menyve në përputhje me bilancin ushqyes, të kulturave dhe mënyrave të jetesës, moshës ose gjendjes shëndetësore;
- Të përshkruajë mënyrën e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së aksesorëve të nevojshëm gjatë ushqyerjes;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të vakteve ushqimore, si proces i rëndësishëm në mirëmbajtjen e shëndetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përfshirjes së individëve në nevojë në hartimin e menisë;

### ***Sigurimi i higjienës dhe kujdesit shëndetësor,***

- Të përshkruajë mënyrën dhe domosdoshmërinë e respektimit të rregullave të higjienës;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së higjienës në parandalimin e sëmundjeve;
- Të listojë efektet që vijnë nga mosrespektimi i rregullave të higjienës dhe masat për të parandaluar dhe korrigjuar ato;
- Të përshkruajë mënyrat për sigurimin dhe ruajtjen e higjienës në ambientin rrethues të individit;
- Të listojë protokollet për ruajtjen e higjienës së personave të asistuar dhe higjienën personale si në situata normale ashtu dhe në raste epidemie apo pandemie;
- Të listojë veprimet kryesore për ruajtjen e shëndetit;
- Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe dezinfektimit të pajisjeve dhe mobilie, ambientit, pajisjet mjekësore dhe ato të argëtimit;

### ***Organizimi i sigurisë***

- Të listojë masat parandaluese për sigurinë e personave të asistuar;
- Të listojë masat parandaluese dhe teknikat që ndiqen për sigurinë personale në punë;
- Të identifikojë burime të paafëtisë duke propozuar dhe zbatuar zgjidhje dhe masa parandaluese;
- Të përshkruajë mënyrën e administrimit dhe zhvillimit të hapësirës për hir të komoditetit dhe sigurisë;
- Të përshkruajë rastet dhe mënyrën e ndihmës praktike për lëvizjen e individëve me aftësi të kufizuar;
- Të përshkruajë teknikat që përdoren për mobilizimin e personave me probleme të ndryshme invaliditeti;
- Të listojë faktorët që përbëjnë rrezikshmëri për aksidente në punë;
- Të përshkruajë faktorët e riskut për dëmshmërinë e shëndetit në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të mjeteve ndihmëse (karrocë me rrota, bastun, karrige mbështetëse etj. ) në parandalimin e aksidenteve;
- Të përshkruajë teknikat për lëvizjen e individëve të paralizuar nga karroca në shtrat dhe nga shtrati në karrocë;
- Të përshkruajë rëndësinë e përkrahjes së pavarësisë së individit në nevojë pa çënuar sigurinë e tij/saj;

### ***Edukimi dhe transmetimi i njohurive***

- Të përshkruajë mënyrat dhe metodat e transmetimit të njohurive dhe informacioneve të nevojshme;
- Të listojë metoda të mobilizimit të potencialit të individit dhe të sjelljeve të tij;
- Të përshkruajë një ndërhyrje edukative duke përdorur metoda dhe teknikat të përshtatura;
- Të përshkruajë mënyrat e inkurajimit të aftësisë për të vlerësuar dhe vetë-vlerësuar sukseset dhe nevojat e një individi;
- Të shpjegojë nevojën e përshtatjes/integrimit të individit me ambientin ku jeton dhe përvetësimin e akteve dhe veprimeve të jetës së përditshme;
- Të listojë zgjidhje për përmirësimin, riorganizimin dhe pajisjen e ambientit në funksion të aktivitetit që do të kryhet;
- Të përshkruajë teknikat lehtësuese në shpërndarjen e informacionit tek individët në nevojë;
- Të shpjegojë rëndësinë e motivimit të individëve në nevojë gjatë procesit të edukimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përkrahjes së individëve në nevojë në shprehjen e ndjenjave, mendimeve dhe emocioneve;

### ***Aktivite argëtuese***

- Të shpjegojë domosdoshmërinë e aktivizimit të aftësive profesionale apo argëtuese të individit në nevojë (p.sh pikturë, skulpturë, zeje të ndryshme profesionale....);
- Të përshkruajë modele dhe forma organizimi të aktiviteteve argëtuese;
- Të përshkruajë rolin që luajnë aktivitetet argëtuese në interaktivizimin midis individëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e gjithë përfshirjes së individëve në aktivitetet që organizohen;
- Të përshkruajë rëndësinë e aktiviteteve në përmirësimin e gjendjes emocionale;

### ***Organizimi i pushimit***

- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së personit për (pushim) gjumë dhe natën;
- Të përshkruajë kushtet optimale për pushim;
- Të përshkruajë rëndësinë e regjimit të pushimit në ciklin ditor të aktiviteteve të individit;
- Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së pajisjeve të sigurisë (raftet e krevatit, etj.);
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së dhomës për gjumë dhe natën;
- Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes së temperaturës së ambientit të gjumit;
- Të përshkruajë rëndësinë e ventilimit të dhomës dhe / ose zonën e gjumit;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes apo përshtatni së shtratit sipas situatës;

### ***Ndihma dhe kujdesi shëndetësor(mjekësor);***

- Të përshkruajë anatominë dhe fiziologjinë e trupit të njeriut: të organeve shqisore, sistemet neuromuskulare, skeletik, të qarkullimit të gjakut, të frymëmarrjes, urogenital, gastrointestinale, endokrine;
- Të përshkruajë anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës dhe mukozës;
- Të përshkruajë disa situata patologjike dhe pasojat mbi gjendjen klinike të sëmundjes së personit: sëmundje akute, sëmundje kronike, situatat emergjente, situata të fundit të jetës, shprehje të dhimbjeve dhe vuajtjeve;
- Të shpjegojë konceptin e sëmundjeve dhe lidhjen ndërmjet shëndetit dhe sëmundjes;
- Të shpjegojë ndryshimet fiziologjike që ndodhin në moshën e tretë;



- Të përshkruajë ndërhyrjen e faktorëve social në shfaqjen e sëmundjeve mendore;
- Të listojë disa sëmundje somatike dhe sëmundje mendore;
- Të shpjegojë proceset patologjike të një situatë sëmundjeje duke listuar shenjat paralajmëruese, shenjat klinike, ngjyra e lëkurës, të vjella, urinë, ndryshimi i gjendjes;
- Të listojë shenjat e sjelljes gjatë një dhimbjeje dhe mënyrën të vlerësimit drejt të shkalles së saj;
- Të listojë teknikat dhe mjetet e vlerësimit të një ndryshim të papritur në sjelljen;
- Të listojë disa shenjat psikologjike dhe të sjelljes: identifikimi, të kuptuarit, elementet të predisponibilitetit të sjelljes.....;
- Të listojë disa shenjat të depresionit; ankth, apatia, impulsivitet, nervozizëm, agresioni;
- Të listojë disa çrregullime të shëndetit; çrregullime të vëmendjes, disorientim në kohë dhe hapësirë, çrregullime të gjykitimit, arsytimit, çrregullime në të folur, çrregullime të lëvizjeve, të gjumit, oreksit, funksioneve njohëse,.... dhe masat që duhen marrë për rastet përkatëse;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve kardiovaskulare dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të mushkërive dhe rrugëve të frymëmarrjes dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit muskuloskeletik dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit të tretjes dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjet hormonale dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të aparatit urogenital dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve infektive dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat kryesore në rastet e sëmundjeve të lëkurës dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë shkaqet dhe simptomat e sëmundjeve kancerogjene;
- Të përshkruajë simptomat e diabetit dhe masat përkatëse që duhen marrë për raste emergjente;
- Të përshkruajë simptomat e sëmundjeve të syrit dhe veshit;
- Të përshkruajë teknikat e shoqërimit të një individi të verbër;
- Të listojë rregullat kryesore që duhet të monitorohen gjatë marrjes së një mjekimi (barnash);
- Të listojë disa nga çrregullimet që mund të ndodhin gjatë marrjes së medikamenteve dhe veprimet që duhen ndërmarrë në rastet e emergjencës;
- Të listojë shenjat në raste të hipertermisë apo hipotermisë dhe të përshkruajë veprimet emergjente/ të domosdoshme në rregullimin e temperaturës;
- Të listojë shenjat kryesore në rastet të çrregullimeve të tensionit të gjakut masat që duhen marrë sipas rastit;
- Të rendisë hapat që duhet të ndërmerren për përgatitjen, ruajtjen dhe sigurimin e një të moshuari gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;

- Të përshkruajë veprimet që duhet të kryejë gjatë monitorimit të një të moshuari të sëmurë që është duke marrë një serum, një mjekim tjetër apo që ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale;
- Të përshkruajë veprimet që duhet të kryejë gjatë monitorimit të një të moshuari që është duke marrë një infuzion, oksigjen ose që është duke përdorur pajisje të tjera mjekësore;
- Të listojë disa nga pajisjet apo mjetet që do të përdoren duke ndihmuar mjekun apo infermierin për një proces konkret që do të kryhet (garzë, produktet ...);
- Të përshkruajë masat për parandalimin e infeksionit gjatë vendosjes dhe heqjes së kateterit;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes dhe instalimit të një aparati aerosol;
- Të listojë disa nga rastet emergjente të personat e moshuar dhe mënyrën e veprimeve që duhen ndërmarrë sipas rastit;
- Të përshkruajë hapat e njoftimit që duhet të bëjë në rast humbje jete të individit që përkujdeset;
- Të përshkruajë hapat e kujdesjes për trupin e individit që humb jetën;
- Të përshkruajë hapat në kujdesin e një shërbimi funeral në institucionet shëndetësore;
- Të listojë disa nga parazitët/dëmtuesve(parazitëve, p.sh. morra, ...) dhe masat/veprimet që duhen ndërmarrë për të luftuar kundër tyre;

### **Mbrojtja e mjedisit**

- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së mjedisit si mënyrë jetese në komunitet;
- Të shpjegojë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit;
- Të listojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e ambientit;
- Të listojë llojet dhe emërtesat e mbetjeve urbane apo spitalore;
- Të dallojë ndryshimet mes mbetjeve organike dhe inorganike;
- Të shpjegojë format e mbrojtjes ndaj mbetjeve të kontaminuara me lëndë kimike apo biologjike dhe trajtimin e tyre;
- Të përshkruajë protokollat kryesore për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së mbetjeve në burim sipas informacioneve të dhëna;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të detergjenteve ose lëndë dezinfektuesve të duhura për ambientin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor;
- Të përshkruajë disa mënyra të pastrimit dhe dezinfektimit të materiale të ndryshme që lidhen me higjienën;
- Të përshkruajë disa mënyra të pastrimit dhe dezinfektimit të materiale të ndryshme që lidhen me higjienën;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

### **Individi duhet të jetë i aftë:**

#### **Menaxhim dhe sipërmarrje**

- Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Të përdorë TIK në shërbim të veprimtarisë;
- Të hartojë një plan të thjeshtë biznesi;
- Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar një projekt ide sipërmarrëse (për të zhvilluar dhe zbatuar një buxhet të caktuar);
- Të përdorë metoda dhe teknika të ndryshme të zbatimit të një projekti dhe menaxhimin e një buxheti të caktuar;

- Të analizojë të dhëna për të marrë vendimet e duhura në kontekste të ndryshme;
- Të negociojë ide me të tjerët në mënyrë efektive;
- Të demonstrojë aftësi udhëheqëse në situata të ndryshme;
- Të menaxhojë stafin profesional, duke promovuar talentet dhe zhvillimin e mundësive të karrierës.
- Të vlerësojë veçoritë e tregut dhe llojet e konsumatorëve në një sipërmarrje;
- Të bashkëveprojë me bankat dhe institucionet financiare për biznesin;
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës.

### **Organizimi i punës**

- Të bëjë organizimin e punës së përditshme;
- Të planifikojë një proces të përkujdesjes geriartrike;
- Të dokumentojë procesin e përkujdesjes geriartrike;
- Të përdorë metoda të ndryshme të analizës së informacionit të mbledhur dhe vendosjes së prioriteteve;
- Të zbatojë metodat e diagnostikimit të situatës, për të vlerësuar potencialin e individit, si dhe disavantazhet e tij, të metat dhe paaftësitë;
- Të zbatojë etapat e hartimit të një plani të përkujdesjes shëndetësore ndaj individit sipas nevojave dhe aftësive të tij për ta realizuar;
- Të respektojë planifikimin e punës sipas përparësive dhe emergjencave;
- Të respektojë me rigorozitet koordinimet dhe komunikimet me stafin tjetër: mjekësor, infermierinë, paramedikale, administrative etj.;
- Të negociojë në ndarjen e detyrave të punës së përditshme;
- Të marrë masat parandaluese në raste pandemie në parandalimin dhe në mospërhapjen e infeksioneve;
- Të zbatojë masat për mbrojtjen e shëndetit personal sipas protokolleve shëndetësore për individët që ofrojnë kujdes shëndetësor;
- Të zbatojë mënyrën e duhur të realizimit të shërbimeve në banesë në distancë, për parandalimin e përhapjes së infeksioneve;
- Të vendosë përparësitë dhe prioritetet në një situatë të dhënë duke pasur parasysh aftësitë e njerëzve, mjedisin, burimet, kufizimet etj.;
- Të menaxhojë kohën sipas objektivave ditore;
- Të rishikojë planet e veprimit individual në përputhje me rrethanat e reja për të përgatitur një ndërhyrje të mëvonshme;
- Të plotësojë formularin e evidentimit me të dhënat e marra nga matja e shenjave vitale.
- Të raportojë sistematikisht për mbarëvajtjen e punës sipas hierarkisë;

### **Komunikimi**

- Të zbatojë rregullat specifike të komunikimit me individë të moshës së tretë;
- Të vëzhgojë mënyrën se si ndryshon sjellja e individit gjatë komunikimit në punën tuaj;
- Të kontrollojë nivelin e shëndetit mendor dhe olistik nëpërmjet komunikimit;
- Të respektojë modelet e ndryshme kulturore dhe mënyrën sesi ato mund të ndikojnë në komunikim;
- Të përdorë teknikat e stimulimit të aftësive mendore dhe fizike;
- Të vëzhgojë prezencën e dyshimeve për keqtrajtim;

- Të raportojë rastet e dyshimeve për keqtrajtim;
- Të komunikojë me etikë profesionale me familjarët e individëve të moshuar;
- Të shmangë paragjykimet dhe keqkuptimet gjatë komunikimit me të moshuar;
- Të respektojë traditat, kulturën dhe zakonet krahinore të individëve të moshuar;
- Të përdorë metoda specifike për gjithë përfshirjen e të moshuarve në aktivitete;
- Të përzgjedhë formën e duhur të komunikimit në lidhje me gjendjen specifike të të moshuarit;
- Të shfaqë interes për problemet sociale të të moshuarit me qëllim parandalimin e depresionit;
- Të informojë të moshuarin për kryerjen e procedurave shëndetësore;
- Të prezantojë saktë dhe në mënyrë profesionale shërbimit të klienti i moshuar;
- Të orientojë drejtë klientin e moshuar në rast pamundësie të ofrimit të një shërbimi të kërkuar;
- Të zbatojë metodat e intervistimit, dëgjimin dhe vëzhgimin duke pasur parasysh moshën e dhe gjendjen fizike të individit të asistuar;
- Të zbatojë mënyrën e paracaktuara të dokumentimit dhe raportimit të shkruar dhe gojor sipas rastit të dhënë;
- Të përdorë modelet e duhura të komunikimit në marrëdhëniet familjare, të gjeneratave të ndryshme dhe marrëdhëniet ndërkulturore;
- Të zbatojë parimet e përgjithshme të komunikimit ndërpersonal dhe ndërinstitucional;
- Të zbatojë mënyrën e duhur të komunikimit me institucionet të tjera si, policia, shërbimi shëndetësorë, këshilltarët, psikologu apo njerëz të tjerë;
- Të përzgjedhë dhe vendosë forma të reja të komunikimit p.sh. përmes platformave dixhitale, duke siguruar që njerëzit mund të vazhdojnë të kenë akses të ri dhe mbështetje;
- Të mbështesë anëtarët e tjerë të familjes në periudhën para ose pas vdekjes së një anëtari të saj;
- Të komunikojë në mënyrë të përshtatshme për sigurimin e standardeve dhe ruajtjen e kufijve të nevojshëm sipas situatave;
- Të aplikojë parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë;

### **Puna në grup**

- Të përdorë teknikat e organizimit dhe lehtësimit të grupit;
- Të krijojë klimën e respektit dhe të mirëbesimit reciprok;
- Të ndërtojë marrëdhënie të ngrohta sociale;
- Të zbatojë teknikat e mobilizimit, vlerësimit dhe veprimit në grup;
- Të përzgjedhë teknikën e duhur në varësi të hapësirës dhe kohës në dispozicion;
- Të bashkëpunojë me koleget dhe familjarët e të moshuarve në zgjidhjen e problemeve të të moshuarit;
- Të përdorë metoda specifike për gjithëpërfshirjen e të moshuarve në aktivitete;
- Të përdorë teknika e menaxhimit të konflikteve që mund të lindin gjatë aktiviteteve;
- Të zbatojë parimet e punës në grup;

### **Të drejtat, detyrimet dhe etika profesionale**

- Të respektojë rregullat e etikës, konfidencialitetin dhe diskrecionin profesional;
- Të zbatojë parimet e humanizmit në jetën e përditshme;
- Të informojë anëtarët e familjes për të drejtat dhe detyrat e tyre;

- Të informojë familjarët dhe të moshuarit mbi direktivat kryesore të politikave për mbrojtjen e të moshuarve;
- Të respektojë të drejta dhe detyrime të një individi në nevojë në një situatë të dhënë;
- Të respektojë parimin e autonomisë dhe të privatësisë gjatë përkujdesjes për individët në nevojë;
- Të zbatojë etikën profesionale të kujdestarit për të moshuar;
- Të zbatojë ligjshmërinë përkatëse të shërbimit social-shëndetësor për të moshuar;
- Të zbatojë parimet e garantimit të të drejtave të njeriut;

#### **Aktivite kryesore të jetës së përditshme**

- Të shoqërojë dhe kujdeset për të moshuarin në aktivitetet e jetës së përditshme (të ushqyerit, larë duart, larja e dhëmbëve, përvetësimi të pastërtisë, veshja ...);
- Të ndihmojë të moshuarin në kryerjen e aktiviteteve që dëshiron ( ujtja e luleve, leximi, shëtitja, lojëra argëtuese etj. ).
- Të ofrojë kujdes në lidhje me higjienën personale dhe rehatin e një të moshuari;
- Të respektojë privatësinë e të moshuarit gjatë kryerjes së higjienës personale;
- Të bëjë një larje/dush një të moshuari si: ( pastrim/larje fytyre, hundë, dhëmbët, kujdesi për veshët, organet gjenitale, etj.) sipas procedurave të përcaktuara;
- Të zhveshë, veshë apo ndihmojë një të moshuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve;
- Të inkurajojë të moshuarin për ti kryer vete shërbimet e nevojshme ( në rastet e mundura);
- Të parandalojë formimin e dekubituesve tek të moshuarit e paralizuar;
- Të pastrojë materiale të ndryshme që lidhen me higjienën personale;
- Të jap ndihmën e duhur teknike sipas rasteve, në përdorimin e aparateve apo pajisjeve të përdorimit të përditshëm(syzet, aparate dëgjimi ...);
- Të nxisë zhvillimin e autonomisë dhe shoqërizimit të të moshuarit;
- Të menaxhojë situatat e emergjencave dhe të krizës në punën në grup të të moshuarve;

#### **Organizimi i vakteve**

- Të kryejë blerje të ushqimeve të nevojshme sipas këshillimeve dhe kërkesave të paracaktuara;
- Të kryejë menaxhimin e një buxheti të caktuar për aktivitetet e jetës së të përditshme;
- Të respektojë traditat dhe kulturën e individëve në të ushqyer;
- Të marrë pjesë në hartimin e menyve në përputhje me bilancin ushqyes, të kulturave dhe mënyrave të jetesës, moshës ose gjendjes shëndetësore;
- Të respektojë mënyrën e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së aksesoreve të tjerë të nevojshëm për gatimin dhe ushqyerjen;
- Të respektojë vaktet ushqimore të individit të moshuar si proces i rëndësishëm në mirëmbajtjen e shëndetit;

#### **Organizimi i sigurisë,**

- Të respektojë masat parandaluese për sigurinë e personave të asistuar;
- Të zbatojë mënyrën e duhura të administrimit dhe zhvillimit të hapësirës për hir të komoditetit dhe sigurisë;
- Të ndihmojë dhe inkurajojë individët me aftësi të kufizuar për lëvizje;

- Të asistojë individët e moshuar në përdorimin e mjeteve ndihmëse (karrocë me rrota, bastun, karrige mbështetëse etj. ) në parandalimin e aksidenteve;
- Të zbatojë teknikat për lëvizjen e individëve të paralizuar nga karroca në shtrat dhe nga shtrati në karrocë;
- Të ndihmojë të moshuarin e verbër gjatë lëvizjes;
- Të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme;

### **Edukimi dhe transmetimi i njohurive**

- Të zbatojë mënyrat dhe metodat e transmetimit të njohurive dhe informacioneve të nevojshme;
- Të zbatojë metoda e mobilizimit të potencialit të individit dhe të sjelljeve të tij;
- Të realizojë një ndërhyrje edukative duke përdorur metoda dhe teknikat të përshtatura;
- Të asistojë në përshtatjen/integrimin e individit me ambientin ku jeton dhe përvetësimin e akteve dhe veprimeve të jetës së përditshme;
- Të propozojë zgjidhje për përmirësimin dhe pajisjen e ambientit ose riorganizimin e tij në funksion të aktivitetit që do të kryhet;
- Të motivojë individët në nevojë gjatë procesit të edukimit;
- Të lehtësojë individin në nevojë në shprehjen e ndjenjave, mendimeve dhe emocioneve;

### **Organizimi i pushimit**

- Të përgatitë individin e moshuar për (pushim) gjumë dhe natën;
- Të respektojë kushtet optimale për pushim ( temperaturë, ajrosjen...);
- Të përgatitë dhomën për gjumë dhe natën;
- Të vendosë pajisjet e sigurisë (raftet e krevatit, etj.) së individit në nevojë gjatë pushimit;
- Të kryejë ajrosjen e dhomës dhe / ose zonën e gjumit;
- Të përgatitë apo përshtatë shtratin e individit në nevojë sipas situatës;

### **Kryerja e aktiviteteve edukative, rekreative dhe argëtuese;**

- Të përdorë metoda dhe teknika të përshtatura në varësi autonomisë, gjendjes fizike, të ndonjë sëmundjeje ose paaftësie;
- Të përdorë metoda dhe teknika të duhura për nxitjen e aftësisë së vlerësimit dhe vetë-vlerësimit të sukseseve dhe nevojave të të moshuarit;
- Të propozojë dhe të organizojë aktivitete stimuluese për grupe të ndryshme të të moshuarve, në varësi autonomisë, gjendjes fizike, të ndonjë sëmundjeje ose paaftësie;
- Të organizojë festa për ngjarje specifike për të moshuarit p.sh. përvjetorë, ditëlindje etj.;
- Të motivojë të moshuarin për të marrë pjesë në aktivitete argëtuese.
- Të përgatisë/kryejë veprimtari argëtuese dhe edukative në përputhje me autonominë, gjenden fizike apo paaftësinë dhe interesat e të moshuarve;
- Të përgatisë/seleksionojë materiale, tregime, libra, muzikë të përshtatshme etj.;
- Të dekorojë dhe zbukurojë ambiente, lokale sipas situatave;
- Të kujdeset për të moshuarin në një shëtitje;

### **Ndihma dhe kujdesi shëndetësorë**

- Të ofrojë kujdesin e duhur, sipas moshës dhe gjendjes fizike, në lidhje me ushqimin;

- Të përgatisë të moshuarin për të marrë ushqim kur është e nevojshme ( për mëngjes, drekë,...etj.);
- Të respektojë sasinë dhe cilësinë e ushqimit dhe të pijeve të konsumuara nga i moshuari;
- Të vëzhgojë tolerancën e tretjes së ushqimit tek i moshuari;
- Të ndërhyjë në rastet kur i moshuari ka kolle, mbetje ushqimi në rrugët e frymëmarrjes apo vështirësi në gëlltitje;
- Të parandalojë sëmundjet që lidhen me kequshqyerjen e individëve të moshuar;
- Të inkurajojë ushqyerjen e të moshuarit sipas udhëzimeve të dietologut e përcaktuar nga diagnoza e sëmundjes;
- Të vëzhgojë oreksin, ngopjen, tolerancën e tretjes;
- Të pastrojë dhe dezinfektojë materiale të ndryshme që lidhen me ushqimin;
- Të ofrojë kujdes në lidhje me jashtëqitjen e të moshuar kur është e nevojshme;
- Të ndërrojë pampersin e një të moshuari, kur është e nevojshme;
- Të ndihmojë të moshuarin, kur është e nevojshme, gjatë kohës së tualetit, fazave të ndryshme që lidhen me mbajtjen e pastërtisë;
- Të krijojë kushte të favorshme për të rënë në gjumë dhe të monitorojë ritmet e gjumit dhe pagjumësinë së një të moshuari;
- Të vëzhgojë gjendjen e përgjithshme të të moshuarit (pamjen, pastërtinë, shkallën e mobilitetit, ndërjegjësimi, hidratimit, ...), autonominë dhe sjelljen;
- Të vëzhgojë ngjyrën, integritetin, thatësinë, ngrohtësinë/temperaturën, butësin e lëkurës ...;
- Të respektojë shenjat patologjike: ënjtje, plagë, skuqje, irritime, rrjedhje, hematomat ...
- Të monitorojë pikat mbështetëse së të moshuarit;
- Të respektojë reagimet e një individi, nivelin e komunikimit, gjendjen e stresit, emocionin, qëndrueshmërinë, gjuhën (të folurën), kohë-hapësirë, orientimin ...;
- Të identifikojë shenjat e dhimbjeve të ndryshme të një individi;
- Të identifikojë shenja të abuzimit;
- Të vëzhgojë dhe masë parametrat vitale;
- Të matë shenjat vitale: temperatura, peshë, normat e zemrës, norma e frymëmarrjes ...
- Të monitorojë rrugët urinare, të zorrëve, çrregullimet e tretjes apo të vjella të mundshme;
- Të monitorojë cilësinë dhe kohëzgjatjen e gjumit, apo pa gjumësisë;
- Të vëzhgojë ndryshimet e këtyre gjendjeve dhe mospërputhjet gjatë matjes së parametrave dhe të marrë masat e duhura në raste të mospërputhjes së parametrave jetësorë;
- Të vëzhgojë mirëfunksionimin e pajisjeve dhe mjeteve mjekësore;
- Të kujdeset për parapërgatitjet gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;
- Ta përgatisë dhe sigurojë individin gjatë një vizite mjekësore, analize apo ndërhyrje kirurgjikale;
- Të monitorojë një të moshuar të sëmurë që është duke marrë një serum, një mjekim tjetër apo që ka bërë një ndërhyrje kirurgjikale;
- Të respektojë rregullat e asepsisë në mirëmbajtjen e kateterit, drenave etj.;
- Të monitorojë të moshuarin për shenja të alergjisë gjatë dhe pas marrjes së mjekimit;
- Të monitorojë një të moshuar që është duke marrë një infuzion, oksigjen ose që është duke përdorur pajisje të tjera mjekësore;
- Të sigurojë pajisjet apo mjetet që do të përdoren duke ndihmuar mjekun apo infermierin për procesin që do të kryhet(garzë, produktet ...);

- Të ndihmojë infermierin, gjatë zgjimit të parë mbas një ndërhyrje ose fizioterapie të një të operuari;
- Të kujdeset për gjendjen emocionale të të moshuarit para dhe pas një operacioni;
- Të përgatisë dhe instalojë një aparat aerosol;
- Të ndihmojë gjatë marrjes së një mjekimi (barnash) dhe të respektojë reagimet e individit;
- Të identifikojë raste të hipertermisë apo hipotermisë dhe të ndihmojë në rregullimin e temperaturës;
- Të vrojtojë dhe monitorojë rastet e humbjes së peshës (shkaqet, ndikim sëmundje, pasojat etj.) dhe të bëjë informimet e duhura te personat përgjegjës;
- Të kryejë veprime themelore emergjente sipas rastit;
- Të ndihmojë në kujdesin e një shërbimi funeral në institucionet shëndetësore;
- Të identifikojë praninë e dëmtuesve (parazitëve, p.sh. morra....) dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të luftuar kundër tyre;
- Të kujdeset për individë me çrregullime të frymëmarrjes dhe sëmundje kardiovaskulare;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje të aparatit gastrointestinal dhe urogenital;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje të aparatit muskuloskeletik;
- Të kujdeset për individë me çrregullime dhe sëmundje infektive duke zbatuar rregullat përkatëse të shërbimit;
- Të kujdeset për individë me çrregullime të dëgjimit, shikimit dhe neuropsikiatrike duke përdorur teknikat përkatëse të shërbimit;
- Të kujdeset për të sëmurë me probleme onkologjike kronike ose në gjendje terminale;
- Të respektojë privatësinë gjatë kujdesit për trupin e individit që humbet jetën;
- Të kujdeset për individë vartës ndaj substancave apo drogave të ndryshme;
- Të kujdeset për individë me probleme endokrinologjike si diabeti apo tiroidet;
- Të kujdeset për individë me probleme të përkohshme post kirurgjikale si plagë operacioni;
- Të respektojë procedurat përkatëse në lëvizjen e një pacienti të imobilizuar.

**Sigurimi dhe mirëmbajtja e ambientit të përshtatshëm në varësi të moshës, autonomisë, të ndonjë sëmundjeje ose paaftësie;**

- Të pastrojë, dezinfektojë të gjitha pajisjet dhe mobilie e përshtatshme duke zbatuar protokollet e duhura;
- Të zhvillojë hapësirën në varësi të nevojave të individit, pajisjeve dhe mobileve;
- Të përgatisë dhe mirëmbajë dhomën dhe pajisjet e saj;
- Të respektojë dëshirat e të moshuarit në vendosjen e sendeve personale në dhomë.
- Të evakujë lavanderinë apo pajisjet e papastra;
- Të kontrollojë dhe të ndërrojë herë pas individin në nevojë;
- Të pastrojë dhe dezinfektojë materiale të ndryshme që lidhen me jashtëqitjen;
- Të para-dezinfektojë, pastrojë dhe dezinfektojë pajisjet e ambientit, pajisjet mjekësore dhe ato të argëtimit;
- Të hedhë mbeturinat në enë të përshtatshme dhe në vendin e duhur;
- Të instalojë dhe të mbajë pastër pajisjet e ndryshme shumë përdorimshe brenda shërbimit;
- Të kujdeset gjatë përdorimit dhe të ruajë pajisjet specifike;
- Të kujdeset për të sterilizuar apo të dezinfektuar materialet;
- Të kontrollojë afatet e skadimit të pajisjeve, mjeteve apo materialeve të tjera;



- Të kujdeset dhe mirëmbajë pajisjet e përdorura individë me sëmundje infektive;
- Të mirëmbajë pajisjet specifike sipas vendeve përkatëse;
- Të informojë familjarë të personit të asistuar duke përdorur mënyrën e duhur të komunikimit;

### **Mbrojtja e mjedisit**

- Të zbatojë politikat ambientale për ruajtjen e mjedisit.
- Të shmangë faktorët ndikues në ndotjen e ambientit.
- Të zbatojë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e ambientit.
- Të diferencojë llojet e mbetjeve në urbane apo spitalore.
- Të zbatojë udhëzimet për mbrojtjen ndaj mbetjeve të kontaminuara me lëndë kimike apo biologjike dhe trajtimin e tyre.
- Të zbatojë protokollet për trajtimin e mbetjeve spitalore ose urbane.
- Të kryejë ndarjen e mbetjeve në burim sipas informacioneve të dhëna.
- Të përzgjedhë detergjente ose lëndë dezinfektuese të duhura për ambientin ku zhvillojnë aktivitetin e tyre ditor.
- Të vendosë kontejnerë të posaçëm për mbeturina që përbëhen nga mjete prerëse.

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

### **Nxënësi duhet të jetë i aftë:**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.